

Objektivat në rritjen e viçave

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioner i AUSTRIA Prämix shpk.




- Menaxhim optimal i kulloshtërës
- Rritje e shpejtë për ripërtypësit.
- Optimizim i kostove të rritjes .
- Shmangie e humbjeve të viçave të shëndetshëm.

Rritja e viçave fillon me përgatitjen e planit të ndërzimit

- Gjenetikat prindërore ndikojnë në pjellje dhe në zhvillimin e viçit.
- Të bëhet përzgjedhja korrekte e demit.
- Lopa të përgatitet mirë për pjellje.
- Të ofrohet ushqimi për performancë të lartë dhe ushqim për shkëputje.
- Të bëhet përgatitja për procesin e pjelljes.
- Pjellja të bëhet në një mjedis të pastër dhe të ofrohet ndihmë gjatë këtij procesi.

Zhvillimi i viçit në barkun e lopës



Dallimi i shenjave të pjelljes dhe interpretimi i saktë i tyre

- Të shënohet në kalendarin e afshit apo në orën e stallës çdo moment i rëndësishëm në mbarvajtjen e kafshës.
- Lopa të thahet në periudhën e duhur.
- Të dhënat në kompjuterin e stallës të jenë të aktualizuara (nëse ka një të tillë në dispozicion).
- Tabelat në stallë mund të sigurojnë informacione të mira.

Pjellja duhet të kryhet në kushte higjenike!

- Marteniteti të përgatitet për pjelljen dhe mundësisht të shtrohet me shumë kashtë.
- Në rastet kur është e nevojshme të ofrohet ndihmë gjatë pjelljes. Të përdoren litare tërheqës të pastra, ose një vinç mekanik tërheqës për ndihmë në raste pjellje të vështira.
- Kordoni i kërthizës të pastrohet me alkool ose jod.
- Të përgatiten kova me ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë.
- Ndhima e tërheqjes bëhet vetëm 1 deri në 2 orë pas plasjes së qeskës amniotike.

- Para së të përdoret ndihma me tërheqje, të kontrollohet pozicioni i viçit me duar të pastra ose më mirë akoma me dorashka veterinare.
- Të pozicionohet me kokë dhe këmbë në dalje—të tërhiqet vetëm gjatë dhimbjeve të lindjes—të respektohen intervalet e kontraktimeve.

Masat që duhen marrë pas pjelljes:

- ✓ Të bëhet fshirja dhe tharja e viçit.
- ✓ Lëpirja e lopës stimulon qarkullimin e gjakut të viçit—një ndihmesë e rëndësishme për vitalitetin e viçit.
- ✓ Dezinfektimi i kërthizës me spray blu, jod dhe alkool.
- ✓ Freskimi i kokës së viçit me ujë dhe frymëmarja krijojnë gjallëri.
- ✓ Të pastrohen dhe të thahen sekrecionet e gojës dhe të hundës.
- ✓ Kulloshtira vlen si ushqim ashtu edhe si mjekim. Viçi duhet të konsumojë kulloshtër menjëherë brenda 3 orëve pas lindjes për të forcuar sistemin imunitar dhe sidomos për t' u mbrojtur nga mikrobet patogjene.
- ✓ Mbetjet e plaçentës duhet të largohen plotësisht pas 4-18 orësh.

Një plan i mundshëm i rritjes së viçave, kur viçat do te mbahen për remont:

Nga dita 1–3 Të ofrohet kulloshtër të paktën 3 herë në ditë.

Deri në ditën e 7 Të rritet sasia konsumit të qumështit në rreth 6 l/ditë ose viçi të pijë nga lopa.

Vëzhgime të sakta

Java e 2-të	6-8 l qumësht /ditë	Të fillohet me koncentrat të freskët për viça – çdo ditë.
Java e 3-të	6-8 l qumësht /ditë	Koncentrat për viça të freskët / sanë cilësore – çdo ditë.
Java e 4-të	6-8 l qumësht /ditë	Koncentrat dhe sanë gjithmonë të freskët.
Java e 5-të	6-8 l qumësht /ditë	Koncentrat dhe sanë, mundësisht silazh cilësor të freskët.
Java e 6-të	6-8 l qumësht /ditë	Koncentrat, sanë dhe silazh cilësor gjithmonë të freskët.